




Pranuar / Dorezuar Prijmjen / Prodato Received / Delivery	18.12.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org. / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SK/MS/CK	7538/2023		1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OF THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1385/2023

**Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë; me Sabile Avdyli-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1385/2023, të datës 07.11.2023, të parashtruar nga ankuesi.

kundër organit të punësimit: Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.12.2023, mori këtë:

### V E N D I M

**Hedhet poshtë si e parakohshme** ankesa me numër A.nr.1385/2023, e datës 07.11.2023 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Nëpunësi civil, (tutje referuar vetëm ankuesi), më datë 07.11.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me shenjën A.Nr.1385/2023, me pretendimin ankimor se kategorizimi i tij në pozitën Udhëheqës i Sektorit të Skemës Sociale në klasën Profesional 1, është i padrejtë, sepse një pozicionim i tillë është në shperputhje me ligjin i cili përcakton ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve.

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 15.11.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Kjo e fundit, më datë 23.11.2023 ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen për vendosje.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankuesit është e parakohshme, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës konkretisht Aktin e Emërimit me numër AE.Nr.01-112/01-0101126/22 të datës 09.11.2022, rezultoi se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit të Skemës së Ndhmës Sociale" në kuadër të Qendrës për Punë Sociale/Drejtoria e Mirëqenies Sociale, në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Me tej, nga shkresat e lëndës rrjedhë së ankuesi ka realizuar koeficient tetë pikë pesë (8.5) të pagës, sipas sistemit të vjetër të pagave, kurse, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 8/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ankuesi është klasifikuar në klasën Profesional 1, C=Gj27-5.66/594.30/1 euro.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se kategorizimi i tij në pozitën Udhëheqës i Sektorit të Skemës Sociale në klasën Profesional 1, është i padrejtë, sepse një pozicionim i tillë është në shperputhje me ligjin i cili përcakton ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, ..... 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr. 10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik. Në këtë rast, në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Mitrovicës së Jugut, nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (i aplikueshëm në këtë periudhë) dhe Rregullores(QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por, si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve, të përcaktuar me Vendimin Nr. 04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK), Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr. 04/128, të datës 16.02.2023, dhe Vendimit Nr.17/162 të datës 27.09.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës

publike janë të obliguara që ta përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjësisht deri me datë 31.12.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankuesit për kategorizimin e pozitës së tij në kategorinë tjetër me të lartë, është e parakohshme dhe si e tillë, në këtë fazë, nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritot. Rrjedhimisht, e njëjta, është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar më lart, ankuses do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që, mbështetur në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, i Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1385/2023

Sabile Avdyli

*Sabile Avdyli*  
Procesmbajtëse

*Ardita Haxhnikaj-Demi*  
Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

